

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"PRESTIGE TRAINING" SHPK**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**Prestige Training**" SHPK, eshte themeluar nga ortakut i shoqerise **Z. Kliti Likaj**, shtetas Shqiptar, i biri i Besnikut, lindur ne date 10.08.1991 , ne Tirane dhe banues ne adresen Rruga Kont Leopord Bertold, pall 165, Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes Shqiptare me Nr.BC0172825, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjofitmit personal me nr. J10810062E, Ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise nr. 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Neni 1

Shoqeria eshte person juridik i te drejtes shqiptare dhe gezon te drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit te themelimit e te ketij statuti.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Neni 2

Sherbime Keshillimi, Menaxhimit te Projekteve, te Edukimit dhe trajnimit ndaj te treteve ne fushen e teknologjise se informacionit dhe komunikimit, burimeve njerezore, te promovimit, studimeve te tregut. Aktiviteti i sherbimeve dhe mirembajtjes kryesisht ne fushen e Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit.

Gjithashtu, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji i zbatueshem ne Republiken e Shqiperise.

## **SELIA E SHOQERISE**

### **Neni 3**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**Prestige Training " shpk**, ka seline e saj ne adresen: " **Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Sulejman Delvina, pallati perball Qendres Zayed Center, kati i 2-te Tirane**", **Shqiperi**. Shoqeria mund te kryeje e te transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit.

## **KOHEZGJATJA**

### **Neni 4**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete pa afat, me mundesine e zgjatjes apo te shkurtimit te afateve, te ndryshoje veprimtarine, emertimin, seline, objektin e veprimtarise sipas vendimit te ortakeve te shoqerise.

## **DETYRIMI I ORTAKUT**

### **Neni 5**

Ortaket e shoqerise duhet te kryeje depozitimin e kapitalit themeltar per llogari te shoqerise ne nje banke te caktuar prej tyre.

## **TRANSFERIMI I KUOTAVE**

### **Neni 6**

Ortaket mund te kalojne pjesen nga kapitali themeltar personave te tjere ne perputhje me rregullat e parashikuara ne nenin 73 te ligjit 9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

## PARAQITJA KONTABILE

### Neni 7

Operacionet e shoqerise kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit te parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktesi ne bilancin vjetor te aktivitetit. Ne mbyllje te cdo viti ortaket ose personi i ngarkuar prej tyre, ben inventarizimin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin dhe harton raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar.

## KAPITALI THEMELTAR

### Neni 8

Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga 100 (nje qinde) leke, dhe zoterohet 100 % nga nje ortak i vetem. **Kapitali perbehet nga nje kuote me vlere 100 (njeqinde) leke.**

Kuotat , me vendim ortaku jane lirisht te transferushme tek cdo individ ose person juridik nepermjet akteve juridike (kontrate shitblerje, trashegimnise, dhurimit ose cdo menyre tjeter te parashikuar nga ligji.

Ky kapital do te shlyehet nga ortaku themelues pas regjistrimit te shoqerise.

## OPERACIONET FINANCIARE

### Neni 9

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve te kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

## BLERJET E SHOQERIVE

### Neni 10

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e shoqerise. Ne Republiken e Shqiperise, shoqeria gezon te drejten e saj per te zoteruar mjete te saj si ne cdo shoqeri tjeter ose organizate tregtare, kombetare shqiptare ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

## FONDI REZERVE

### Neni 11

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin e tij. Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e tyre perdorimi dhe rregullimi i tyre (i cdo fondi) percaktohet nga ortaku i shoqerise ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te shoqerise raportohen ne bilance te shprehur ne leke shqiptare, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republikën e Shqiperise. Bilanci dhe perllogaritjet ekonomike te shoqerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoqerite tregtare ne Shqiperi. Bilanci vjetor mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.

## PLANET FINANCIARE

### Neni 12

Aktiviteti i shoqerise mbi bazen e programeve financiare qe bejne pjese ne aktivitetin financiar te saj. Planet financiare parashikojne koston dhe te ardhurat e shprehura ne leke shqiptare. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do te paraqiten ne leke shqiptare.

Rezultatet financiare te aktivitetit dhe te punes se kryer nga shoqeria, paraqiten ne bilancin vjetor. Kursi i kembimit te monedhes shqiptare ne monedhat e huaja dhe e kunderta do te jene ato te vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

## ORGANET E SHOQERISE

### Neni 13

Organi vendimarrës i shoqerise "**Prestige Training**" SHPK eshte Ortaku i Vetem **Z. Kliti Likaj**. Ortaku i vetem është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të ortakut;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

## **MBLEDHJA E ORTAKUT TE SHOQERISE**

### Neni 14

Ortaku i shoqërisë mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Ortaku i vetem thirret nga administratori apo me iniciative të tijë përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji. Mbledhja e përgjithshme thirret nëse:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

## **PËRFAQËSIMI**

### Neni 15

Ortaku mund të përfaqësohet në mbledhje, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakut në

mbledhje.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## MARRJA E VENDIMEVE

### Neni 16

Ne baze të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, ortaku i Vetem vendos për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

## PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ORTAKUT

### Neni 17

Të gjitha vendimet e ortakut të vetem duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes;

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së përgjithshme në këtë faqe.

## ADMINISTRATORI

### Neni 18

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar administrohet nga një ose disa persona fizike. Administratori i shoqërisë emërohet me vendim të Ortakut të shoqërisë. **Afati i**

**qendrimin e detyre i administratorit te shoqerise eshte per nje periudhe 1 (nje) vjecare.**

Administrator i kesaj shoqerise eshte **Z. Kliti Likaj**, shtetas Shqiptar, i biri i Besnikut, lindur ne date 10.08.1991, ne Tirane dhe banues ne adresen Rruga Kont Leopord Bertold, pall 165, Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes Shiptare me Nr.BC0172825, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjofitmit personal me nr. J10810062E.

Administratori i shoqerise i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe u njeh ligji shprehimisht ortakeve.

Administratori ka pergjegjesi ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkeljet e ligjeve, statutit apo shkeljeve te kryera gjate administratimit.

## **RASTET E PUNES**

### **Neni 19**

Raportet e punes ndermjet shoqerise, filialeve dhe agjensive te saj si dhe te punonjesve ne te, rregullohen ne baze te kontrates se punes, konform Kodit te Punes.

Per sa nuk parashikohet ne kontraten e punes, aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

### **Neni 20**

Shoqeria merr persiper, te shlyeje rregullisht te gjitha detyrimet e saj qe burojne nga legjislacioni per sigurimet shoqerore e shendetesore lidhur me te punesuarit e saj.

## **PERFUNDIMI I AKTIVITETIT**

### **Neni 21**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar priset:

**1.Me kalimin e afatit per kohezgjatjen e saj ne kontraten e themelimit.**

**2.Per pamundesine e realizimit te objektit te saj.**

3.Me vendimin e gjykates.

4.Me hapjen e procedurave te falimentit si edhe me te gjitha menytrat e tjera, sipas parashikimeve te legjislacionit ne fuqi.

#### LIKUJDIMI

Neni 22

Likujdimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit.

#### KUSHTET E TJERA

Neni 23

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete, statut do ti referohen plotesimeve qe mund te beje ortaku i shoqerise, si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Per regjistrimin e shoqerise "**Prestige Training**" SHPK, dhe depozitimin e akteve perkatese prane Qendres Kombetare te Biznesit, procedura do te ndiqet nga ortaku i vetem i shoqerise Z. Kliti Likaj.

Ky statut firmoset rregullisht.

Per shoqerine tregtare "**Prestige Training**" SHPK.

#### ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Z. Kliti Likaj

*Kliti Likaj*  
*klj*

Tirane, me 15.01.2021